



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>ZD/DPK</u>	Br. Prot. <u>01-2746/15</u>
Dep. <u>ZD/DPK</u>	Prot No. <u>01-2746/15</u>
Nr. i faq.	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages <u>2</u>	Date <u>14.09.2015</u>
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.09.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-1043/15, për znj. Valbona Osmani – Drejtoreshë në Inspektoratin Policor të Kosovës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshem për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti me nr. AKK – 03-1043/15 për znj. Valbona Osmani – Drejtoreshë në Inspektoratin Policor të Kosovës, e dyshuar për konflikt interesi sepse kishte marrë pjesë në trajtimin e rastit të z. Aziz Nika – Hetues në Inspektoratin Policor të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në tekstin e mëtejshëm Ligji PKI).

Dyshimet për konflikt interesi në këtë rast kanë qenë se znj. Osmani ka qenë kryetare e komisionit disiplinor për trajtimin e rastit të z. Aziz Nika, me të cilen, z. Nika ka pretenduar se ka marrëdhënie armiqësore.

Kjo për faktin se, sipas tij, znj. Osmani e ka dëmtuar me rastin e marrjes së vendimit të komisionit disiplinor, për të cilen z. Nika edhe e ka denoncuar. Prandaj, pretendimi i z. Nika ka qenë se znj. Osmani ka vepruar armiqësisht ndaj tij.

Mirëpo, Agjencia kundër Korrupsionit, në bazë të shkresave të kësaj lënde dhe në bazë të deklaratave të palëve, nuk ka gjetur fakte që dëshmojnë se znj. Osmani, ka konflikt interesi në trajtimin e këtij rasti.

Fakti që z. Nika e ka denoncuar znj. Osmani në komisionin disiplinor, për shkak të vendimit ndaj tij, nuk ia ndalon asaj që të jetë pjesë e këtij komisioni në rishqyrtim dhe rivendosje. Këtë nuk e ndalon as Udhëzimi Administrativ (Nr.13/MPB-2011) për Përcaktimin e Shkeljeve, Masave Disiplinore dhe Procedurës Disiplinore ndaj Punonjësve të IPK-së.

Andaj, bazuar në nenin 18 (pika 10) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, duke marrë parasysh të gjitha faktet që i posedojmë në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit për këtë rast, vlerësojmë se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

